



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 3
Prishtinë, më 19 tetor 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Çaraniq, Faton Topalli, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Blerim Kuçi dhe Zafir Berisha.

Stafi mbështetës i komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Mentor Hyseni- GIZ; Albert Krasniqi –KDI; Genc Nimoni- “ÇOHU”; Valmir Ismaili-D+; Besa Shatri-Audit&Conto; Shefki Kastrati-NDI; Miradije Mavriqi- KQZ; Valon Krasniqi- AKK dhe Bedri Mecini-AKK.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Tërheqja e shortit lidhur me auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016;
3. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi që miratohet rendi i ditës, pa ndryshime.

2. Tërheqja e shortit lidhur me auditimin e raporteve vjetore financiare dhe raportet e deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike, për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016

Kryetari- Administrata e komisionit, në koordinim me mua, ka përgatitur një metodologji se si të zhvillohet tërheqja e shortit. Pra, duke pasur parasysh edhe bazën ligjore, janë kujdesur maksimalisht që një auditor të mos auditojë, dy vite radhazi, të njëjtin subjekt politik. Këtu kemi dy lloj zarfesh: në zarfin e vogël kemi emrat e auditorëve, ndërsa në zarfet e mëdhenj kemi grupet e subjekteve politike, pra do të zgjidhet auditori dhe grupi me subjekte politike, që do t'i auditojë ai auditor.

Avduhall Hoti- Unë kam një vërejtje. Në formularin që kemi marrë, në mbledhjen e fundit, kemi një ndryshim tek emri i një auditori, në njërin draft është Qerim Qerimi, ndërsa në tjetrin Qerim Qerkini. Ndërsa, çështja e dytë është se në mbledhjen e kaluar, unë kam kërkuar që komisioni vlerësues të sjellë në komision një deklaratë, ku cekin që auditorët e përzgjedhur i plotësojnë kushtet sipas nenit 19, pika 2 të Ligjit për financimin e subjekteve politike.

Ismet Krasniqi, sekretar i Kuvendit- Sa i përket emrit, është çështje teknike. Në listën zyrtare është Qerim Qerimi. Ndërsa, sa i përket deklaratës që po e kërkon deputeti, unë kam deklaruar që e gjithë puna bëhet në deklaratën nën betim, prandaj ne nuk e shohim të arsyeshme një deklaratë shtesë, përderisa e kemi deklaratën bazike.

Shqipe Pantina- Unë kam një pyetje. Deklaratën, a e nënshkruajnë auditorët, individualisht apo operatori ekonomik, se nuk e kam të qartë këtë?

Ismet Krasniqi, sekretar i Kuvendit- Deklaratën në dosje e keni edhe nga operatori ekonomik, por edhe nga gjykata, po ashtu kanë edhe vërtetime, që nuk janë nën hetime. Po ashtu, e kemi pasur edhe auditorin e jashtëm, gjatë këtij procesi këtu dhe nuk kanë pasur asnjë vërejtje rreth këtij procesi.

Kryetari- Tani po vazhdojmë, i hedhim zarfet në kuti dhe vazhdojmë me përzgjedhjen. Ndarja me short është:

Grupi 1

Fatmir Mehmeti	PRBK.	17	2013
	NDS	11	2016
	PAI	13	2015
	BSDAK	20	2014
	GIG	16	2014
	IRDK	21	2014
	PLE	12	2016

Grupi 2

Agron Mustafa	GIG	22	2013
	IRDK	15	2013
	PLE	12	2015
	NDS	11	2015
	PDAK	10	2016
	BSDAK	14	2013
	SDSKIM	19	2014

Grupi 3

Haxhi Nimanaj	PDAK	10	2015
	KDTP	7	2016
	NDS	13	2013
	JSL	18	2014
	PDS	9	2015
	VAKAT	8	2016
	PAI	12	2013

Grupi 4

Njazi Jakupi	SLS	17	2014
	VAKAT	8	2015
	PDS	9	2016
	PDAK	11	2013
	KKR	16	2014
	KDTP	7	2015
	NISMA	6	2016

Grupi 5

Besa Sahitaj Berisha	SDSKIM	10	2013
	KNRP	15	2014
	NISMA	6	2015
	AAK	4	2016
	VAKAT	9	2013
	KZA	14	2014
	Srp. Lista	5	2015

Grupi 6

Muhamet Feka	Srp. Lista	5	2016
	KDTP	8	2013
	PLE	13	2014
	AAK	4	2015
	VV	3	2016
	JSL	7	2013
	PDS	12	2014

Grupi 7

Ymer Shatri	VV	3	2015
	KNRP	15	2016
	SLS	6	2013
	NDS	11	2014
	LDK	2	2015
	PDK	1	2016
	KKR	5	2013

Grupi 8

Fadil Hyseni	PAI	10	2014
	PDK	1	2015
	LDK	2	2016
	AAK	4	2013
	PDAK	9	2014
	KNRP	15	2015
	KZA	14	2016

Grupi 9

Elmj Osmani Shatri	VV	3	2013
	VAKAT	8	2014
	KZA	14	2015
	PAI	13	2016
	LDK	2	2013
	KDTP	7	2014
	PDK	1	2013

Grupi 10

Qerim Qerimi	NISMA	6	2014
	SRPSKALISTA	5	2014
	AAK	4	2014
	VETËVENDOSJE	3	2014
	LDK	2	2014
	PDK	1	2014
	PRBK.	23	2014

Kryetari- Të nderuar të pranishëm, ky proces, sipas komisionit, përfundoi. Operatori ekonomik, sipas kontratës, nga sot ka 45 ditë kohë ta përfundojë auditimin e subjekteve politike.

Me kaq e konsideroj këtë takim të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj